

**URDHËR**  
**Nr. 1, datë 6.1.2025**

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore”; të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin Publik”, të ndryshuar; të pikës 2, të nenit 73, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Delegimin e kompetencave të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, znj. Ledina Beqiraj Agalliu, me detyrë sekretar i përgjithshëm pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për të gjitha procedurat e prokurimit publik me fonde buxhetore për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.
  2. Kompetencat e deleguara të Titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit do të ushtrohen për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në datën 31 dhjetor 2025.
  3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri sekretari i përgjithshëm.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT**  
**Mirela Kumbaro Furxhi**